



Zgjedhjet - Izbori - Elections

Demokracia në Veprim
Demokratija na Delu
Democracy in Action

Jeton jashtë Kosovës

Voto për Kosovën!

Zgjedhjet Lokale – 3 Nëntor 2013

www.demokracianeveprim.org

Votuesi me të drejtë vote i cili përkohësisht gjendet jashtë Kosovës mund të votojë për zgjedhjet në Kosovë nëse ai ose ajo ka aplikuar për Votim Jashtë Kosovës dhe ka votuar në përputhje me rregullat e Komisionit Qendor të Zgjedhjeve (KQZ). Vota përmes Votimit Jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja para ditës së zgjedhjeve. Procesi i votimit nga Jashtë Kosovës realizohet përmes postës.

Çdo qytetar që konsideron se ka të drejtë dhe është i interesuar për të votuar duhet të aplikojë për t'u regjistruar si votues jashtë vendit. Pas aplikimit KQZ-ja do të ju njoftojë nëse kërkesa e juaj është aprovuar apo jo. Të gjithë aplikuesit e aprovuar do të pranojnë fletëvotimet e caktuara dhe materialet tjera përcjellëse në adresën e paraqitur gjatë aplikimit.

- ✓ Të gjithë qytetarët të cilët janë të regjistruar si shtetas të Republikës së Kosovës dhe që kanë dokumente të identifikimit të Republikës së Kosovës ose të UNMIK-ut, duhet ta shkarkojnë **Formularin e Aplikimit për Votim Jashtë Kosovës** dhe të njëjtin të plotësuar ta dërgojnë në KQZ.
- ✓ Të gjithë ata që nuk janë të regjistruar, por që kanë të drejtë që të jenë shtetas të Republikës së Kosovës, duhet ta shkarkojnë **Formularin për Regjistrim dhe Aplikim Jashtë Kosovës** dhe të njëjtin të plotësuar ta dërgojnë në adresë të KQZ-së.

Formularët mund të shkarkohen nga uebfaqja e KQZ (www.kqz-ks.org), tek butoni shërbimi i votuesve. Formulari i plotësuar, së bashku me dokumentet e kërkurara, duhet të arrij në KQZ më së largu deri më **4 shtator 2013**. Formularin e plotësuar me një kopje të dokumentit që dëshmon se jeni shtetas i Republikës së Kosovës apo që keni të drejtë për shtetësi, mund t'i dërgoni:

Përmes postës:

Adresa: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,
Votimi Përmes Postës, K.P.6 Kutia 351,
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Përmes e-mailit zyrtar:

ovpp@kqz-ks.org ose ogpp@kqz-ks.org; dhe

Përmes fax-it në numrin:

+381 (0) 38 213 200

Për të plotësuar kushtet që të votoni nga jashtë Kosovës ju duhet që:

- ✓ Të jeni 18 vjeçar/e apo mbi, deri në ditën e zgjedhjeve më 3 nëntor 2013,
- ✓ Të jeni të regjistruar në Regjistrin Civil të Republikës së Kosovës dhe të posedoni dokumente të identifikimit të Republikës së Kosovës ose të UNMIK-ut, ose
- ✓ Të keni dëshmi që vërteton se jeni person legjitim për t'u regjistruar në Regjistrin Civil të Republikës së Kosovës.

Për Votuesit Jashtë Kosovës

Cilat zgjedhje

Zgjedhjet lokale për Kuvendet Komunale dhe Kryetarët e Komunave.

Data e Zgjedhjeve

3 Nëntor, 2013

Afati për Aplikim

4 Shtator 2013, dokumentet e kërkuara duhet të arrijnë në KQZ.

Shkarkimi i Formualit

Mund të shkarkohet nga uebfaqja e KQZ, tek butoni shërbimi i votuesve.

Dërgimi i Formularit

Mund të bëhet përmes postës, emailit zyrtar të KQZ ose përmes fax-it.

Uebfaqja e KQZ

Për më shumë informata vizitoni www.kqz-ks.org.



www.demokracianeveprim.org